

Policia Bashkiake

Bruna Keli

Mban pozicionin e punës si Krye Inspektore e Policisë Bashkiake që nga muaji Mars 2014. Më parë ka punuar në Drejtorinë e Policisë Berat. Ka përfunduar studimet në Akademinë e Rendit Publik

Të organizojë dhe realizojë ruajtjen e objekteve dhe pasurive të Bashkisë dhe atyre që administrohen prej saj.

Të siguroje zbatimin efektiv të akteve të Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak që kanë të bëjnë me realizimin e punëve dhe shërbimeve publike.

Të siguroje zbatimin e urdhrave të Kryetarit të Bashkisë që kanë të bëjnë me personat juridike e fizike që nuk plotësojnë konform ligjit detyrimet financiare e fiskale ndaj Bashkisë, si dhe çdo detyrim tjetër pasuror ndaj tyre.

Të mbikqyre, kontrollojë nëse shtetasit në administrimin e pasurisë apo ushtrimit të aktivitetit të tyre ,respektojnë aktet Bashkiake.

Të konstatojë e parandalojë ndotjet e mjedisit ,hedhjen e mbeturinave të ndryshme jashtë pikave të caktuara si dhe dëmtimin e sipërfaqeve të gjelbërta të qytetit. Të marrë masa për respektimin e akteve të vendosura nga shërbimi veterinar.

Të kujdeset e të marrë masa për respektimin e orarit të shërbimit të njëjësive tregtare, shërbimet, bufeve, restoranteve, lojrave të fatit etj, si dhe për respektimin nga ana e tyre të urdhrave të Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.

Të kujdeset për ruajtjen e afisheve, njoftimeve e shpalljeve publike, si dhe heqjen e atyre të paligjshme e të pa autorizuara.

Të kontrollojë marrjen e masave të sigurisë që parandalojnë fatkeqësitë dhe të ndihmojë në parandalimin e tyre.